



## VENDIMET E BORDIT TË DATËS 09 PRILL 2020

Në mbledhjen e Bordit Drejtues të Federatës të mbajtur më 09 Prill 2020, me shumicë votash të anëtarëve u morën këto vendime:

### **Vendimi Nr. 2020-21**

#### **Organizimi i kurseve Online**

- Miratohet me shumicë votash propozimi për organizimin e kurseve online. Si pasojë e “Covid 19” FTK do të shfrytëzojë platformat online për të organizuar gjatë kësaj periudhe kurset në vijim

1. Kurs për administrimin e klubeve
2. Kurs për referë
3. Kurs për antidoping

Datat dhe informatat tjera relevante do të koordinohen nga administrata dhe komuniteti ditëve në vijim.

### **Vendimi Nr. 2020-22**

#### **Ankesa ndaj Arzen Rifatit**

- Bordi me shumicë votash merr vendim që referit Arzen Rifatit të i shqiptohet vrenjtje me shkrim për futjen e një lojtari në short pas hedhjes dhe publikimit të tij dhe caktimit në mënyrë arbitrare të kundërshtarit të tij ndërkohë që shkeljet e tjera jo vetëm për ju por edhe për referate e tjerë do të pasojnë me gjobitje financiare.